



**UNIVERSITETI I MITROVICËS**  
**UNIVERSITY OF MITROVICA**  
**"ISA BOLETINI"**

Rruga Ukshin Kovaqica, Mitrovicë, Republika e Kosovës  
<http://www.umib.net>; Tel: +381-28535725/535727

Kryesues i Këshillit Drejtues  
Dr. sc. Ali Topalli

Nr. Prot. 1096/005  
Datë 31.05/2019

Këshilli Drejtues i Universitetit të Mitrovicës "Isa Boletini", në mbledhjen e mbajtur më 27.5.2019, mori:

**VENDIM**

- I. Mandati i organeve të dala nga Zgjedhjet e Përgjithshme 2019, për Fakultetin Juridik, Ekonomik dhe Fakultetin e Edukimit fillon më 1 qershor 2019.
- II. Marrja e mandatit të organeve të dala nga zgjedhjet e Përgjithshme 2019 prej datës 1 qershor 2019 vlen vetëm për Fakultetin Juridik, Fakultetin Ekonomik dhe Fakultetin e Edukimit.
- III. Me marrjen e mandatit të organeve të dala nga zgjedhjet e përgjithshme 2019 për fakultetet nga pika I dhe II të këtij vendimi, pushon mandati i ushtruesve të detyrës së dekanit, ushtruesve të detyrës së prodekanit dhe çdo pozite tjetër në statusin e ushtruesit të detyrës për secilën nga këto njësi akademike.
- IV. Vendimi hyn në fuqi menjëherë.

**Arsyetim**

Në Universitetin e Mitrovicës "Isa Boletini" janë mbajtur zgjedhjet e përgjithshme 2019, me ç'rast janë konstituuar Këshillat e njësive akademike. Sipas nenit 4, paragrafi (1) të Rregullave dhe Procedurave për zgjedhjet e përgjithshme në UMIB: "Të gjithë mandatarët të cilët zgjidhen ligjshëm përmes këtyre zgjedhjeve, do të mbajnë mandatin e tyre për katër vjet". Meqenëse në Fakultetin Juridik, Fakultetin Ekonomik dhe Fakultetin e Edukimit, në vitin 2015 nuk janë plotësuar kushtet formale për mbajtjen e zgjedhjeve të përgjithshme, për shkak të mungesës së stafit akademik dhe administrativ, ato kanë funksionuar me pozita menaxhuese në statusin e ushtruesve të detyrës dhe pa këshilla të njësive akademike.

Këshilli Drejtues, pushimin e mandatit të pozitave menaxhuese me status të ushtruesve të detyrës dhe funksionalizimin e Këshillave të njësive akademike për këto tri njësi akademike prej 1 qershorit 2019 e konsideron të arsyeshme, për shkak se njësitë akademike janë në prag të dy proceseve të rëndësishme që janë kompetencë ekzkluzive e vendimmarrjes nga Këshillat e Njësive akademike, e që janë: propozimet për numrin e ri të studentëve dhe procesi i pranimit të studentëve të rinj për vitin akademik 2019/2020 dhe propozimi për shpalljen e konkursit për staf të ri akademik. Gjithashtu, funksionalizimi i këtyre njësive me organe të rregullta ndihmon dhe garanton

funkcionimin normal të çdo procesi në nivel të njësisë akademike, siç janë edhe: aprovimi i temave të studentëve, procedura e diplomimit, etj.  
Bazuar në këto që u cekën si më lartë, Këshilli Drejtues vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi t'i dërgohet:

1. Arkivit të UMIB-it,
2. Rektorit të UMIB-it,
3. Fakultetit Juridik
4. Fakultetit Ekonomik
5. Fakultetit të Edukimit
6. Zyrës së personelit
7. Zyrës për çështje akademike
8. Shërbimit financiar
9. Zyrtarit ligjor



Dr. sc. Ali Topalli

Kryesues i Këshillit Drejtues